



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 01.02.2023)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit (relator z. Ilir Rusi):

- 1.1 Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Apelit Durrës;
- 1.2 Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë;
- 1.3 Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Apelit Korçë
- 1.4 Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:20 dhe mbaroi në orën 15:49.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

- 9. Marçela Shehu* (anëtare)  
*10. Brikena Ukperaj* (anëtare)  
*11. Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit (relator z. Ilir Rusi):
  - 1.1 Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Apelit Durrës;
  - 1.2 Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë;
  - 1.3 Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Apelit Korçë
  - 1.4 Për transferimin e përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

*Naureda Llagami:* Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 1 shkurt 2023.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit është një mbledhje me urgjencë, që ka të bëjë, në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatave, i ka përcjellë për vendimmarrje Këshillit të Lartë Gjyqësor, transferimin e përhershëm të kancelarëve të gjykatave të tjera të apelit.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Ilir Rusi, i cili është edhe kryetar i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit Kryetare!

Përshëndetje të nderuar anëtarë prezent në mbledhje!

Paraqes shkurtimisht relacionin edhe mbi veprimtarinë e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit Tiranë dhe atë çka ajo ka disponuar dhe konstatuar në raport me procesin për mundësinë e sistemimit të kancelarëve të gjykatave të apelit Shkodër, Durrës, Gjirokastrë, Vlorë dhe Korçë.

Në zbatim të vendimit nr. 2, datë 11.01.2023 “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit”, Komisioni i Ristrukturimit në funksionalitetin e tij pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, zhvilloi dy mbledhje përkatësisht më datë 18.01.2023 dhe datë 23.01.2023, në të cilën u diskutua mundësia e sistemimit të kancelarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësor, në kuadër të rior{...}zimit të rretheve gjyqësore.

Në mbledhjen e datës 23.01.2023 Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, i propozoi Kancelarëve në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, mundësinë e transferimit të përhershëm, në pozicionet vakante Kancelar në Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe në pozicionet vakante në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, më konkretisht: Vendet vakante të prezantuara nga Komisioni i Ristrukturimit sipas objektit të përcaktuar në aktin përkatës me të cilin është krijuar ky komision:

- vend vakant Kancelar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër,
- vend vakant Kancelar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës,
- vend vakant Kancelar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë,
- vend vakant Kancelar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër,
- vend vakant Kancelar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin,
- vend vakant Kancelar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec,
- vend vakant Kancelar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë,
- vend vakant Kancelar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- Shef Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm,
- Shef Sektori IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm,
- Shef Sektori i Koordinimit të Zyrave të Shërbimeve dhe Protokoll/Arkivës në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm.

Pas propozimeve të Kryetarëve të gjykatave respektive dhe shprehjes së opinionit personal të Kancelarëve, por në vëmendje kriterin e largësisë së vendbanimit me vendin e punës, rezultoi se, për Kancelaren e Gjykatës së Apelit Korçë, u propozua sistemimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe për Kancelaren e Gjykatës së Apelit Vlorë, u propozua sistemimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ndërsa për sa i përket Kancelarëve të Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjirokastrë, pas parashtrimit të mundësive për sistemim në pozicionin e kancelarit në gjykatat e rretheve gjyqësore, ku aktualisht ky pozicion rezulton vakant, gjykatave, e theksoj, të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe në pozicionet vakante në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk u shpreh vullnet për pozicionimin në asnjë nga vendet e ofruara.

Në mënyrë unanime, Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit, me vendimin nr. 504, datë 23.01.2023, miratoi propozimin e transferimit të përhershëm të kancelarëve, ku u përjashtua nga votimi kancelaret të cilat ishin objekt shqyrtimi si subjekte për sistemimin e tyre:

Për Gjykatën e Apelit Korçë: – Transferimin e përhershëm të znj. {...}, nga pozicioni Kancelar në Gjykatën e Apelit Korçë, në pozicionin Kancelar në Gjykatën e Rrethit Korçë, shkalla e parë juridiksioni i përgjithshëm.

Për Gjykatën e Apelit Vlorë: – Transferimin e përhershëm të znj. {...}, nga pozicioni Kancelar në Gjykatën e Apelit Vlorë, në pozicionin Kancelar në Gjykatën e Rrethit Vlorë, shkalla e parë juridiksioni i përgjithshëm.

Për Kancelaren e Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjirokastrë, Komisioni vendosi përcjelljen e akteve Këshillit të Lartë Gjyqësor, në cilësinë e strukturës kompetente, për vendimmarrje për transferimin e përhershëm të tyre.

Komisioni i Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit, në vijim ka kryer njoftimin elektronik dhe zyrtar të vendimmarrjes kancelarëve, të cilët duhet të shprehen mbi vendimmarrjen përkatëse dhe njoftimi u është bërë nëpërmjet strukturave përkatëse nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Aktualisht, Kancelarja e Gjykatës së Apelit Korçë dhe Vlorë, kanë shprehur dakordësinë mbi vendimin nr. 504, datë 23.01.2023 për transferimin e përhershëm të tyre në gjykatat respektive të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm.

Ndërsa Kancelarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka shprehur dakordësinë mbi vendimmarrjen e transferimit të përhershëm të saj, por vendimmarrjen ta marrë Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kancelarja e Gjykatës së Apelit Durrës nuk ka shprehur opinion, por i qëndron vendimit të Komisionit të Ristrukturimit nr. 504.

Si pjesë të materialeve në këtë mbledhje plenare, janë parashtruar para anëtarëve edhe vendet vakante të cilat janë nxjerrë nga struktura përkatëse në gjykatat e juridiksioneve të ndryshme, të cilat ushtrojnë funksionin e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Njëkohësisht është paraqitur në formë tabelare edhe përvoja në punë e tyre, mendimet e shprehura, dhe për më tej, do t'i kërkoja Këshillit, në raport me diskutimet përkatëse, për të vendosur në lidhje me propozimin e tyre, meqenëse edhe unë kam qenë anëtar i Komisionit të Ristrukturimit dhe e kam shprehur një herë atë bindjen time në raport me qenien anëtar, dhe në vijueshmëri të mbledhjes do të shpreh edhe unë opinionet e mia.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit zoti Rusi.

Atëherë ftoj kolegët nëse kanë ndonjë...? Apo dëshirojnë përpara të dëgjojnë zotin Rusi dhe pastaj të kalojmë në vlerësimin nga ana jonë?

Jemi dakord që të fillojmë me propozimin, duke qenë se ka qenë Kryetar i Komisionit të Ristrukturimit.

*Ilir Rusi*: Do të prezantoj në mënyrë të përmbledhur disa elementë të dosjes së tyre personale të cilët janë elementë thelbësor në raport edhe me kriteret të cilat merren parasysh në rastet e transferimit të përhershëm për shkak të ristrukturimit.

Kemi bërë një renditje sipas alfabetit:

Kancelarja e Gjykatës së Apelit Durrës, znj. {...} (datëlindja 1986); vendbanimi është në Durrës; 2008–2016 ka qenë sekretare gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës; 2016 e në vijim është Kancelare në Gjykatën e Apelit Durrës; është emëruar në këtë detyrë me urdhrin nr. {...}, datë 23.05.2016 të ministrit (sipas përcaktimeve ligjore që kanë qenë në kohën përkatëse). Gjithashtu, kanë kaluar të dy kriteret në lidhje me verifikimin e figurës dhe të pasurisë dhe është në proces pjesa e vlerësimit profesional i cili kryhet në një moment të dytë; ka diplomimin në drejtësi dhe diploma është e nivelit “Master”.

Për Kancelaren e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, znj. {...} (datëlindja 1978); vendbanimi është në Gjirokastrë; ka një përvojë pune nga 2003–2005, sekretare në Ministrinë e Drejtësisë, 2005–2005, juriste në Prefekturën Gjirokastrë, 2013–2014, specialiste juriste në Prefekturën e Qarkut Gjirokastrë dhe për vitin 2014 e në vazhdim është Kancelare e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; edhe kjo sipas përcaktimeve të kohës është komanduar në këtë pozicion me urdhrin e ministrit nr. {...}, datë 20.10.2014. Gjithashtu ka kaluar edhe dy kriteret e verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe është në proces në lidhje me kriterin e tretë që është vlerësimi profesional i saj; është e diplomuar në fushën e drejtësisë.

Kancelarja e Gjykatës së Apelit Korçë, znj. {...} (datëlindja 1985); vendbanimi është në Korçë; në vitet 2008–2014, specialiste juriste në Prefekturën e Korçës dhe për vitin 2014 e në vazhdim Kancelare në Gjykatën e Apelit Korçë; edhe zonja {...} është emëruar në detyrë me urdhrin e ministrit (sipas përcaktimeve ligjore të kohës) nr. {...}, datë 27.12.2013; i ka kaluar të dyja kriteret, të verifikimit të pasurisë dhe të figurës dhe njëkohësisht është e diplomuar në fushën e drejtësisë.

Në lidhje me Kancelaren e Gjykatës së Apelit Vlorë, znj. {...} (datëlindja 1967); vendbanimin e ka në Vlorë; ka një përvojë pune të gjatë: 1996 (*në tabelën me të dhëna viti është shtator 1994, ndaj është lapsus viti 1996*) – 2002, sekretare gjyqësore në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga viti 2002 e në vazhdim ka qenë sekretare gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë, prej vitit 2010 dhe aktualisht, Kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë; njëkohësisht sipas përcaktimeve të kohës edhe kjo kancelare është emëruar me urdhrin e ministrit nr. {...}, datë 04.10.2010; njëkohësisht ka kaluar edhe kriteret në lidhje me kriterin e pasurisë dhe figurës; është e diplomuar në fushën e drejtësisë.

Kancelarja e Korçës dhe Kancelarja e Vlorës, në raport me referimet që janë bërë nga Komisioni i Ristrukturimit për shkak të kufizimit të objektit të veprimtarisë së saj në referim me strukturat, vendet e punës përkatëse, edhe për shkak të vendbanimit, me vullnet dhe me një prezantim nga titullarët përkatës të këtyre gjykatave, sipas funksionit, në rastin konkret, të zëvendëskryetares në raport me Gjykatën e Apelit Korçë dhe kryetares në raport me Gjykatën e Apelit Vlorë, është propozuar Kancelare në gjykatën e rrethit gjyqësor juridiksioni i përgjithshëm në Korçë (përkatësisht Korçë dhe Vlorë), e cila është pranuar, duke qenë edhe në raport me kriterin e largësisë që është më pak se 45 kilometra.

**Naureda Llagami:** Për efektivitet të kohës, kalojmë një nga një? Ju relatoni, ne hedhim në votim, të paktën për këto që kemi vullnetin.

Ishim tek Korça.

**Ilir Rusi:** Në raport me vjetërsinë në punë, po referoj Kancelaren e Apelit Vlorë, znj. {...}, e cila ka shprehur vullnet për t'u pranuar vendimi propozues i Komisionit të Ristrukturimit për t'u transferuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, si kancelare.

**Naureda Llagami:** Jeni dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni i Ristrukturimit? Kemi diskutim?

Po! – çfarë korrigjimi?

**Brikena Ukperaj:** Në pikën 3: “njoftimi i vendimit zonjës {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”, jo “Gjykatës së Apelit”, se sot s’ka më gjykata apeli.

**Naureda Llagami:** E heqim.

Atëherë, me gjithë propozimin e Brikenës, duke qenë se pranohet nga relatori, e hedhim në votim.

Kemi diskutim për këtë propozim?

**Marçela Shehu:** Jo, kam këtë pikëpyetje për sqarim.

Kancelares i janë vënë në dispozicion nga Komisioni vetëm pozicionet e lira si kancleare në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, shkallë e parë?

**Ilir Rusi:** Po, i janë vënë të gjitha vakancat që janë sot në të gjitha gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat ushtrojnë funksionin në Republikën e Shqipërisë, njëkohësisht edhe tre pozicione “shef sektori”, që sot në eventualitet është Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

**Naureda Llagami:** Votim.

Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.



Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Zonja {...}, aktualisht Kancelare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, transferohet në mënyrë të përhershme Kancelare, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 1 shkurt 2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi Kancelares znj. {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt–aktin e dytë propozues.

**Ilir Rusi:** Në lidhje me zonjën {...}, edhe kjo kancelarë ka pranuar vendimin propozues të Komisionit të Ristrukturimit në lidhje me transferimin e saj të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Korçë.

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim sipas propozimit të Komisionit të Ristrukturimit për Gjykatat e Apelit?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Zonja {...}, aktualisht Kancelare pranë Gjykatës së Apelit Korçë, transferohet në mënyrë të përhershme Kancelare, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më 1 shkurt 2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi Kancelares znj. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt–aktin e radhës.

**Ilir Rusi:** Në lidhje me zonjën {...}, Kancelare që ka qenë deri dje në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

*(Duke qenë se në projektvendimin e propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit emri i Kancelares është shënuar {...}, kërkohet të bëhet verifikimi nga ana e administratës lidhur me mbiemrin në gjendjen civile të kancelares në fjalë, për të kaluar më tej në trajtimin e projektvendimit. Deri në ardhjen e informacionit nga struktura përkatëse pranë Këshillit, vijohet me projektvendimin e radhës.)*

**Ilir Rusi:** Në lidhje me znj. {...}, u prezantuan kriteret e saj dhe do ftoja Këshillin për të përcaktuar vendimmarrjen në lidhje me vakancat e ofruara në gjykatat përkatëse të cilat janë të lira, jo vetëm në juridiksionin e shkallëve të para, juridiksioni i përgjithshëm.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Të fillojë Komisioni i Ristrukturimit?

Kalojmë tek diskutimi. Nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, ka ndonjë qëndrim dhe propozim mbi {...}n?

**Marçela Shehu:** Nga Komisioni s’besoj se ka qëndrim.

**Ilir Rusi:** Komisioni nuk ka qëndrim.

**Klodian Kurushi:** Atëherë, nëse më lejoni, mund të bëj një diskutim, ndoshta edhe pas kësaj edhe një propozim?

Meqenëse zonja {...} aktualisht është Kancelare në Gjykatën e Apelit Durrës dhe normalisht ne kemi detyrimin që ta transferojmë, t'i caktojmë një pozicion të ri pune për shkak të suprimimit të Gjykatës së Apelit Durrës; duke parë edhe orkën e gjykatave në Republikën e Shqipërisë për pozicionet e kancelarit, pra që mos të ndryshojnë pozicionin e saj, unë propozoj që zonja {...} të transferohet në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë. Është një vend i lirë në pozicionin e kancelares. Distanca, për merakun tonë është e pranueshme (pra nga Durrësi në Tiranë, ndoshta më pak se 45 km largësi). Kështu që, propozimi im është ky që thashë, meqenëse nuk do ketë më funksione Gjykata e Apelit Durrës, propozoj që Kancelarja në detyrë e kësaj gjykate (deri ditën e djeshme) të transferohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, për sa kohë edhe vendi i kancelares është bosh. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, unë para se të përzgjedhim se cilat nga gjykatat duhet të vendoset për t'u transferuar në mënyrë të përhershme kancelarja, paraprakisht Këshilli duhet të marrë një vendim nëse ne do ta shtrimë procedurën e transferimit përtej vendimmarrjes tonë për fushën e veprimit të Komisionit të Ristrukturimit, sepse Komisioni i Ristrukturimit ka pasur për qëllim sistemimin e kancelarëve brenda gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm. Në kushtet kur propozimi që vjen nga zoti Kurushi nuk ka të bëjë me këto gjykata, por ka të bëjë me gjykata brenda juridiksionit të posaçëm, atëherë Këshilli fillimisht duhet të ketë një vendimmarrje (një vendim i ndërmjetëm do jetë), që cilat do të jenë gjykatat, përveç këtyre të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat do të merren në shqyrtim, për të propozuar transferimin për kancelarët. Pra këtu, ne, duhet të vendosim që përveç Gjykatës të Dibrës, Kukësit,

Kurbinit, Pogradecit, Shkodrës, duhet ta përfshijmë edhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë? Duhet ta përfshijmë edhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Shkodër apo edhe Gjykatën e Lartë?

Nëse ne do të ndajmë tani se cilat janë gjykatat brenda të cilave do të ndodhë transferimi, pra mund të ndodhë edhe jashtë juridiksionit, ku kancelarja ka qenë e punësuar në pozicionin e kancelarit, atëherë ne e kemi shumë të thjeshtë për të bërë propozimet përkatëse, duke marrë parasysh që të dy kancelarët, edhe znj. {...} edhe kancelaren tjetër që kemi në vijim, nuk kanë dhënë pëlqimin për t'u sistemuar në të njëjtin pozicion të së njëjtës kategori në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Në vlerësimin tim, mendoj që përveç këtyre gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të përfshihen si vende vakante për t'u propozuar transferimi edhe gjykatat administrative të shkallës së parë edhe Gjykata e Lartë, në kushtet kur nuk ka ndalim të parashikuar në ligj dhe në kushtet kur ligji parashikon gjithashtu që nëse kancelari nuk sistemohet dot në gjykatën pritëse apo në gjykata të tjera në varësi të gjykatës pritëse, mund të sistemohet në një gjykatë tjetër që është brenda sistemit.

***Naureda Llagami:*** Propozim tjetër?

***Alban Toro:*** Jo, nuk kam propozim. Thjesht doja të argumentoj që pozita e kancelarit është e njëjtë në të gjithë juridiksionet. Kështu që nuk ka lidhje fare juridiksioni i përgjithshëm apo administrativ, për të bërë një përzgjedhje të vendeve, të cilën ne duhet të sistemojmë këtë kancelare. Kështu që unë bashkohem me propozimin e Klodit për ta emëruar tek Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ligji nuk lë shkak të interpretosh që ndryshimi i juridiksionit të na sjelli një ndryshim të funksionit që kanë kancelarët, kur funksioni është i njëjtë për të gjithë gjykatat (të njëjtën detyrë kanë pak a shumë). Kështu që, për sa i përket pjesës tjetër pastaj, të kolegëve të tjerë që sapo emëruam, nuk u kemi afruar pozicione të tilla, është për faktin se kemi respektuar vullnetin, i cili është determinant në këto raste. Kanë përcaktuar vullnetin në ato gjykata

ku i emëruam dhe si të tilla, ai prevalon mbi çdo argument tjetër. Kështu që unë bashkohem me Klodin, me atë propozim.

**Marçela Shehu:** Kam vetëm një diskutim.

Jam dakord me diskutimet e kolegëve, por, atyre kancelarëve që tashmë ne i transferuam, nga Komisioni i Ristrukturimit nuk i është bërë me dije ky fakt, që ata kanë të drejtë të sistemohen si kancelarë edhe në gjykatat e tjera të juridiksionit administrativ apo edhe në Gjykatën e Lartë, siç tha zonja Ukperaj. Pra, mos duket sikur kemi një cenim të standardit dhe të të drejtave të atyre që ne tashmë i transferuam?

**Alban Toro:** Ne i respektuam vullnetin.

Ata preferuan vendin e banimit, dhe si e tillë nuk preferuan Tiranën dhe të pretendonin një gjykatë afër Tiranës apo larg Tiranës, apo në Tiranë.

**Marçela Shehu:** Alban, nëse ne do t'i kishin ofruar gjykatat administrative, mund të ishin gjykata që do i zgjidhnin ato?

**Alban Toro:** Nuk besoj, sepse ato do të jepnin një preferencë. Nuk besoj që mund të kishte ndryshime në opinionin e tyre apo në vullnetin e tyre. I kanë referuar vendit të banimit. Ata kanë përzgjedhur aty ku kanë pasur vendbanimin dhe kanë preferuar edhe të zgjedhin një gjykatë më të vogël në shkallë juridiksioni.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kush e do fjalën?

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Naureda Llagami:** Zonja Ukperaj fjalën!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, ne kemi miratuar një vendim për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe vendin ku ai do të ushtrrojë funksionin. Komisionit të

Ristrukturimit, ne si Këshilli, duke qenë organ emërtese përsëri për kancelarët, i kemi thënë që sistemimin do ta bësh brenda pozicioneve dhe kategorisë së gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm. Nuk e kemi përfshirë gjykatën administrative apo edhe Gjykatën e Lartë ndoshta.

Nga ana tjetër, Komisioni i Ristrukturimit nuk mund të vijë me një propozim konkret, sepse brenda vendeve që ka propozuar, asnjë nga kancelarët nuk ka dhënë pëlqimin. Tani Këshilli, si organ emërtese ka detyrimin që këta kancelarë t'i sistemojë në pozicione të tjera. Nuk jemi të varur ne nga fusha e veprimtarisë së Komisionit të Ristrukturimit. Prandaj, në mendimin tim, duhet të futen në grupin e gjykatave, për të cilat do të bëhet sistemimi i këtyre kancelarëve, pra kemi dy kancelarë, të gjitha gjykatat, edhe gjykatën administrative të shkallës së parë. Unë mendoj që edhe Gjykata e Lartë, por gjithsesi kjo është një çështje e diskutimit që mund të ndodhë nga anëtarët e Këshillit. Pra duhet të futen të gjitha gjykatat, pavarësisht juridiksioneve dhe lëndëve. Dhe nëse ne do ta vendosim këtë gjë, po, ne do dalim tej fushës së veprimtarisë së Komisionit të Ristrukturimit (sepse, prandaj edhe zoti Rusi nuk na ka ardhur me një propozim konkret për dy kancelaret), atëherë mund të vijojmë me propozimin e zotit Kurushi që sigurisht që qëndron sepse është brenda 45 km dhe nuk ka as mundësi refuzimi nga ana e kancelares.

**Marçela Shehu:** Të ngre një diskutim tjetër?

A kemi ne mundësi që t'i transferojmë këto dy zonja në pozicionet ku ato kanë refuzuar?

Ne kemi sot vende vakante në gjykatat e shkallës së parë, apo jo? Kemi në Kurbin, kemi në Shkodër (apo jam gabim për Shkodrën?), kemi në Pogradec. E ka të ndaluar Këshilli që t'i caktojë këto kancelare, t'i transferojë në...?

**Ilir Rusi:** Po nuk i kanë pranuar këto vakanca. Nuk i kanë pranuar këto.

Këto kancelare, me këto emra dhe mbiemra, nuk i kanë pranuar këto vakanca, për kancelar, në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

**Brikena Ukperaj:** Dhe, sipas ligjit “Për statusin”, kancelari ka të drejtë ta refuzojë pozicionin në qoftë se është mbi 45 km. Pra, për sa kohë ata i kanë refuzuar, ne nuk mund t’i sistemojmë kundër vullnetit të tyre, në kushtet kur ne kemi vakanca të tjera në juridiksionet e posaçme, për këta kancelarë.

**Marçela Shehu:** Atëherë, që të sqarojmë.

Ligji ne na detyron që të parashtrojmë ca pozicione të reja të cilat nuk i kishte në dispozicion Komisioni i Ristrukturimit.

**Brikena Ukperaj:** Dhe në këtë rast zonja {...} nuk mund të propozohet kancelare në Gjykatën e Dibrës kur brenda 45 km është vendi vakant në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Është vakancë në sistem, është pozicion i së njëjtës kategori.

**Marçela Shehu:** Është bërë matja e të gjitha gjykatave? 45 km? Shkodër, Pogradec?

**Ilir Rusi:** Është lehtësisht.

**Naureda Llagami:** Atëherë, për të kuptuar çfarë do të hedhim në votim.

Kemi propozimin konkret të zotit Kurushi. Kemi edhe propozimin e zonjës Ukperaj, e cila, le të themi, është si pararendëse për propozimin e zotit Kurushi, e cila thotë që duhet t’i hapim të gjithë. Pra a mundet Këshilli t’i propozojë, personave që kanë refuzuar, pozicione të tjera në juridiksione të tjera?

**Marçela Shehu:** Janë të dy në të njëjtën linjë. Të tre, bashkë me zotin Toro, janë në të njëjtën linjë, pra që ne sot të hapim pozicione të tjera.

**Naureda Llagami:** Proceduralisht Brikena thotë që, para se të bëjmë këtë propozimin, thotë që duhet të marrim një vendim të ndërmjetëm për hapjen. Pra mos të shkojmë direkt në propozim, por ta marrim një vendim të ndërmjetëm.

Kështu që, jemi dakord që të marrim paraprakisht vendimin ndërmjetës për mundësinë e hapjes së pozicioneve për kancelarët edhe në juridiksionet e tjera të posaçme? Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Cilat gjykata konkretisht?

**Brikena Ukperaj:** Propozimi im është... (ndërpritet audio).

*(Anëtarët diskutojnë edhe një herë për t'u qartësuar mbi propozimin e zonjës Ukperaj pa ndezur mikrofonat.)*

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, zonja Kryetare, për të vazhduar propozimin tim, duke marrë parasysh nevojat për kancelarë në gjykata; duke marrë parasysh që ne kemi ende për të vijuar procesin e ristrukturimit të gjykatave të shkallës së parë; duke marrë parasysh detyrimet që na përcakton neni 83 i ligjit “Për pushtetin gjyqësor”, në vazhdim të propozimit, do të thosha që në këtë moment, ndoshta Gjykatën e Lartë duhet ta përjashtojmë nga grupi i gjykatave për të propozuar transferimin për kancelarët, kjo për të pasur edhe një trajtim të njëjtë të të gjithë kancelarëve, në kushtet kur kjo gjykatë nuk iu është ofruar as kancelarëve që tashmë ne i miratuar për transferim; dhe do të propozoj që përveç gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në grupin e gjykatave të përfshihen vetëm gjykatat administrative të shkallës së parë (duke përjashtuar Gjykatën e Lartë).

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Jam dakord që të përfshihen gjykatat administrative, duke bërë përjashtimin për Gjykatën e Lartë, për t'i vënë në një pozitë të barabartë kancelarët në këtë moment.



**Naureda Llagami:** Atëherë, duke qenë se kemi dy propozime dhe duke qenë se propozimi i bërë nga dy koleget përfshin edhe propozimin e bërë nga zoti Kurushi, atëherë unë sugjeroj që të hedhim propozimin e bërë nga zonja Ukperaj dhe nga zonja Shehu, që të përfshihen në ofrimin e pozicioneve të lira edhe gjykatat e juridiksionit të posaçëm, siç janë gjykatat administrative. Kështu që, jemi dakord me propozimin? Më pas, për të kaluar tek propozimi i zotit Kurushi.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek propozimi i cili është propozim konkret i ardhur nga zoti Kurushi, lidhur me zonjën {...}, ai propozon që të transferohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, 1. Zonja {...}, aktualisht Kancelare pranë Gjykatës së Apelit Durrës, transferohet në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 1 shkurt 2023.

3. Njoftimin e vendimit Kancelares znj. {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Prapë fjalën ia jap zotit Rusi, lidhur me propozimin e radhës.

**Ilir Rusi:** Atëherë, në vijim të diskutimeve kemi rastin e Kancelares së Gjykatës së Apelit Gjirokastër, {...}, me ato të dhëna të cilat u prezantuan. Kështu që, meqenëse u përjashtua pjesa e Gjykatës së Lartë, vullneti në lidhje me vendet vakante në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit... janë refuzuar nga zonja {...}, atëherë në referim të vakancave, rezulton që ka vakancë të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Nisur nga vendbanimi i saj, do propozoja që të transferohesh në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

**Naureda Llagami:** Duke qenë se zoti Rusi bëri propozimin konkret, atëherë kalojmë në votim nëse nuk ka ndonjë diskutim nga kolegët?

Nuk ka! Atëherë kalojmë në votimin e propozimit të ardhur nga zoti Rusi.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Zonja {...}, aktualisht Kancelare pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, transferohet në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Vlorë.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 1 shkurt 2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi Kancelares znj. {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Atëherë, me kaq mbyllim çështjen kryesore që kishim, por duke qenë se nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës na kanë ardhur relacionet për vlerësimin e gjykatave që janë në nevojë për caktim, unë do kërkoja 10 minuta kohë për të bërë gati dhe për ta vijuar mbledhjen vetëm për hedhjen e shortit.

Faleminderit!

Takohemi pas 10 minutash.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 01.02.2023)*

***Pika 2 shtesë e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***<sup>2</sup>

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:20 dhe mbaroi në orën 15:49.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Dritan Hallunaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>6. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>8. Marçela Shehu</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

<sup>2</sup> Vijimi i mbledhjes drejtohet nga Zëvendëskryetari.

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

**1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**2. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**3. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

2 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Mbledhja vijon me çështjen e cila u shtua në rendin e ditës dhe që lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Kjo çështje filloi në orën 15:39. Mbledhja drejtohet nga Zëvendëskryetari, z. Ilir Rusi.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Kurushi për të vijuar me relatimin e të gjitha relacioneve për secilën nga kërkesat e paraqitura nga gjykatat që janë në nevojë.

Fillimisht propozohet radha e procedurave të shortit sipas kësaj radhe:

Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

a. Gjykata e rrethit Gjyqësor Kukës.

b. Gjykata e Rrethit gjyqësor Pogradec.

Pasi anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime me radhën e procedurave të shortit, vijohet me relativimin e relacioneve përkatëse.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës** ajo ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbehet nga gjyqtarët {...} dhe {...}; (ka qenë pjesë e trupit gjykues edhe gjyqtari {...}, i cili prej datës 1 janar është komanduar në Ministrinë e Drejtësisë). Gjyqtarja {...} ka gjykuar kërkesën për revokimin e masës së sigurimit; Gjyqtarja {...} ka gjykuar kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim; Gjyqtari {...} ka gjykuar kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë (si gjykata më e afërt në distancë gjeografike).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në ndryshim nga rregulli i zakonshëm, në shortimin e çështjeve, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, konkretisht: znj. {...} (pasi shorti do të ishte i pamundur për t'u realizuar, në kushte kur z. {...} aktualisht është anëtar i trupit gjykues të çështjes penale që po gjykohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës).

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Ermelinda Fejzo.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ajo ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjen nr. 1 në tabelë, më parë KLGJ-ja ka caktuar gjyqtarin {...} (pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë) për gjykimin e kërkesës me objekt “Dërgimin e çështjes për gjyq”; Gjyqtarja {...} ka shqyrtuar kërkesën në fazën e hetimeve paraprake për caktim mase sigurimi; Gjyqtari {...} ka shqyrtuar kërkesat gjatë fazës së hetimeve paraprake për lejim përgjimi.

Për çështjen nr. 2 në tabelë, më parë nga KLGJ-ja është caktuar gjyqtarja {...} për gjykimin e kërkesës me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”; Gjyqtarja {...} ka shqyrtuar kërkesat gjatë fazës së hetimeve paraprake për lejim përgjimi; Gjyqtari {...} ka shqyrtuar kërkesën për caktim mase sigurimi.

Për çështjen nr. 3 në tabelë, më parë gjyqtarja {...} ka gjykuar kërkesat në fazën e hetimeve paraprake për vleftësim arresti; Gjyqtari {...} ka paraqitur kërkesë për heqje dorë e cila është pranuar nga zëvendëskryetarja e gjykatës së apelit Korçë me vendimin nr. 1, datë 25.01.2023.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (si gjykata që ka distancën më të afërt gjeografike).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: z. Besnik Shehu.

Të përjashtohen nga shorti gjyqtarët të cilët aktualisht janë anëtarë të trupit gjykues në çështjet me numrin rendor nr.1 dhe nr.2 në tabelë, konkretisht znj. {...} dhe z. {...}.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2 (ardhur me e-mail), penale, gjyqtarët Gentiana Shukullari dhe Seladin Pysqyli.

Për çështjen nr. 3 (ardhur me e-mail 30.01.2023), penale, gjyqtarja Gentiana Shukullari.

Për çështjen nr. 1 (ardhur me e-mail), penale, gjyqtarët Seladin Pysqyli dhe Gentiana Shukullari.

Me hedhjen e shortit për Gjykatën e Pogradecit, mbledhja plenare deklarohet e mbyllur.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**